



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës,
mbajtur më 5.12.2024, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, (i pavarur), kryesues i Kuvendit, Tria Kasumi-Berisha (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Berna Saraçi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Berat Lahu (LVV), Feim Osmani (LVV), Edmond Azemi (LVV), Ermal Osmani (LVV), Violeta Salihu (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Arbër Limani (LVV), Faton Zeka (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Agron Canolli (PDK), Granit Geci (PDK), Fatmir Dervishi (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Gëzim Mehmeti (AKR).

Munguan: Liridon Selmani (PDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Amir Simnica (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Bahri Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Xhavit Ahmeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Agim Kuleta (LB) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

Të pranishëm ishin edhe: përfaqësues të KFOR-it, OSBE-së, përfaqësues të KMR "Pastrimi" dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit.
Kryesuesi tha se për këtë mbledhje është paraprë ky

Rend i ditës:

1. Anulimi i Vendimit për shfuqizimin e paragrafit 3 të nenit 16, të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, nr. 01 - 060/01-123059/24, të datës 18.9.2024;
2. Ndryshim-plotësimi i Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, nr. 01 - 030/01-227581/23, i datës 1.12.2023.

Faqe nga 6

Pika e parë

Anulimi i Vendimit për shfuqizimin e paragrafit 3 të nenit 16, të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, nr. 01 - 060/01-123059/24, të datës 18.9.2024.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Leutrim Retkoceri tha se ky propozim për shfuqizimin e vendimit lidhur me shfuqizimin e paragrafit 3 të nenit 16 të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, ka ardhur si kërkesë e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ku ka kërkuar që për ndryshimet eventuale në rregullore duhet të ndjekën hapat sipas Udhëzimit administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e akteve të Kuvendit, andaj është e nevojshme të bëhet shfuqizimi dhe anulimi i këtij vendimi, për të vazhduar më pas me diskutimin dhe propozimin për ndryshimet e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave.

Gëzim Sveçla theksoi se ne si Grup parlamentar, qysh herën e parë kur është miratuar kjo rregullore kemi qenë kundër këtij neni, andaj sot e përkrahim shfuqizimin e këtij neni.

Gëzim Mehmeti u shpreh se herën e parë kur është miratuar kjo rregullore kam qenë kundër dhe kam votuar kundër këtij neni, andaj është e domosdoshme që ne të shikojmë përtej interesave afatshkurtra dhe të ndërtojmë një të ardhme dhe një vizion të përbashkët. Për të ardhmen e qytetit, këta hapa janë të domosdoshëm dhe mendoj se nëse dëshirojmë me pasur zgjidhje, duhet të ketë një dialog të hapur dhe të sinqertë, të ulemi së bashku, pa inate personale dhe pa menduar për përfitime politike. T'i ofrojmë mbështetje KRM "Pastrimi", përmes politikave që forcojnë kapacitetet e saj.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për shfuqizimin e paragrafit 3 të nenit 16 të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, nr. 01 - 060/01-123059/24, të dt. 18.9.2024.

Pika e dytë

Ndryshim-plotësimi i Rregullorës për menaxhimin e mbeturinave, nr. 01 -030/01-227581/23, i datës 1.12.2023.

Kryesuesi hapi diskutimin për këtë pikë.

Besart Krasniqi tha se ne, si Lëvizje Vetëvendosje, që nga fillimi e kemi kundërshtuar paragrafin e nenit që ua mundëson operimin kompanive private. Nuk kemi asgjë ndaj kompanive private, por prioriteti ynë mbeten asetet tona publike, siç është në këtë rast KRM "Pastrimi" dhe 900 punëtorët e saj. Pra ne nuk lejojmë dhe nuk pranojmë që të rrezikohet e ardhmja e ndërmarrjes "Pastrimi" dhe mirëqenia e 900 punëtorëve. Po ashtu, nuk lejojmë dhe nuk dëshirojmë të rrezikohet një grant nga KFW (financuar nga Qeveria gjermane) në vlerë prej 70 milionë euro, që ka të bëjë me menaxhimin e mbeturinave dhe riciklimin e tyre. Ne jemi shumë të interesuar për një Prishtinë të pastër e të shëndetshme, por kjo nuk bëhet

duke dëmtuar, falimentuar, bankrotuar një ndërmarrje, kështu që ne besojmë se rimëkëmbja, fuqizimi i kësaj ndërmarrjeje është i mundur.

Leutrim Retkoceri tha se sa i përket procedurës për plotësim – ndryshimin e kësaj rregulloreje ne, si komision, kemi pranuar disa propozime nga qytetarët në dëgjim publik dhe nga asamblistët. Dua të falënderoj të gjithë qytetarët, me një pjesëmarrje të madhe në dëgjimin publik, ani se me pengesa, e falënderoj edhe parafolësin, z. Gëzim Mehmeti, i cili ka kontribuar me 14 rekomandime për t'u përfshirë në Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave. Nga të gjitha propozimet, janë marrë afërsisht 6 nene, të cilat ndihmojnë që kjo rregullore të ndryshohet në përmirësimin e situatës me menaxhimin e mbeturinave në kryeqytet. Propozim- ndryshimi për rregulloren nuk ka asnjë nen diskriminues, por ka nene të cilat tentojnë të zgjidhin situatën e krijuar me mbeturina në kryeqytet.

Gëzim Sfeçla tha se Lëvizja Vetëvendosje ka qenë kundër atij nenit që i lejon operatorët ekonomikë privatë të bëhen pjesë e sistemit për mbledhjen e mbeturinave në Prishtinë dhe në rajon, mirëpo siç e dini, gjendja me mbeturina në Prishtinë as atëherë kur është bërë ky nen, e as tash nuk është ajo që dëshirojmë. Ne sot do ta japim votën tonë për ndryshimin e kësaj rregulloreje, por për Lëvizjen Vetëvendosje mbi të gjitha është e rëndësishme që të kemi një qytet të pastër, natyrisht të mbrojmë asetet publike, siç është "Pastrami", si dhe natyrisht brengosemi dhe kujdesemi për 900 punëtorët e "Pastrimit" dhe të gjitha këto duhet të jenë në funksion të qytetit të pastër dhe për banorët që jetojnë në Prishtinë.

Granit Geci tha se ndjej njëfarë përgjegjësie personale atë ditë kur e kam votuar këtë rregullore edhe pikërisht me këtë që i mundësohet operatorit privat t'i ndihmojë kompanisë "Pastrimi", t'i ndihmojë, jo ta falimentojë, jo ta shkatërrojë, jo t'i dërgojë në shtëpi 900 punëtorë, jo të degradojë një ndërmarrje, e cila i ka rreth 70 vjet prej kur është themeluar e deri më sot, jo ta shkatërrojë një trashigimi të tërë të brezave të cilët kanë punuar me nderë për qytetin e Prishtinës. Më vjen mirë që shumica e Kuvendit sot është këtu dhe është bërë bashkë për me i shpëtuar dy elemente, së pari për me e bërë Prishtinën më të pastër dhe, së dyti, për me pasë mundësi që këta njerëz të vazhdojnë me punën që bëjnë.

Faton Zeka tha se gjendja e mjerueshme në ndërmarrjen "Pastrimi" nuk është as për shkaqe natyrore, as për shkaqe rrethanore, por për shkaqe të keqmenaxhimeve të vazhdueshme nga disa menaxhmente. Andaj, për këtë gjë inkurajoj dhe kërkoj guxim edhe nga ndërmarrja dhe nga punëtorët e ndërmarrjes, që të protestojnë edhe të kundërshtojnë edhe vendimet të këqia të menaxhmentit të ndërmarrjes, vendimet të cilat kanë sjellë deri te kjo gjendje në ndërmarrje që është në buzë të falementimit. Për ne, si Lëvizje Vetëvendosje, pastrami i qytetit është parësor, sepse të gjithë jetojmë në këtë qytet dhe e përjetojmë atë tmerr me mbeturina gjithandej qytetit. Ne sot do t'i japim një mundësi ndërmarrjes "Pastrimi", por që dhe do ta ftojme në përgjegjësi bordin dhe menaxhmentin e ndërmarrjes, me mundësinë e parë që do ta kemi në vitin e ardhshëm.

Muhamet Selmani përkujtoi se kur është votua kjo rregullore, ka qenë që Komuna përmes mundësive të veta ose tenderit dhe angazhimit të kompanive të caktuara, t'i dalë në ndihmë për menaxhimin e mbeturinave ndërmarrjes "Pastrimi". Mirëpo ajo që shofim ne, sidomos nga kontrata të cilën e ka lidhur kjo Komunë për angazhimin e një kompanie për menaxhimin e mbeturinave, shohim se është komplet e kundërta e nenit apo e mundësisë që

e ka lejuar rregullorja. Në këtë rregullore për menaxhimin e mbeturinave është e përcaktuar qartë pagesa për mbledhjen e mbeturinave, kështu që duke e parë këtë keqmenaxhim dhe këtë keqinterpretim, ne jemi të detyruar ta ndryshojmë këtë rregullore, me qëllim të mos lëmë në dorë të keqmenaxhuesve, të cilët kanë qëllimin e vetëm shkatërrimin e një ndërmarrje publike dhe humbjen e një kredie dhe mbështetje financiare që vije nga KFW-ja prej 71 milionë euro.

Feim Osmani tha se që atëherë kur është votuar kjo rregullore, kemi thënë që hartimi i një rregulloreje të mirë e cila do t'i shërbente Kryqytetit për një kohë relativisht të gjatë, do të ishte edhe e pranueshme për ne, e gjithësi e mirëseardhur për banorët e Prishtinës. Ne sot e kemi mundësinë ta përmirësojmë për aq sa mundemi ta përmirësojmë një rregullore të tillë dhe mirëpresim propozimet që kanë ardhur duke i pasuruar edhe me propozimet tjera. Ai kërkoi që konkretisht, paragrafi 1 i nenit 12 të ndryshohet dhe nga kohëzgjatja e lejes mjedisore, të cilën e lëshon Komuna për operatorin në këtë rast, që duhet të jetë SHA "Pastrimi". Kohëzgjatja e kësaj leje mjedisore duhet të jetë në 3 vjet.

Berat Lahu theksoi se në ndërmarrjen "Pastrimi" kemi pasur telashe prej vitit 2014 e tutje, gjithmonë për shkak se është interferuar, është ndërhyrë dhe nuk është menaxhuar asnjëherë mirë. Ndryshimi i kësaj rregulloreje duhet të jetë kushtëzimi që menaxhmenti të ndërmerr masa direkte për të na prezantuar një plan se si do të ristrukturojë ndërmarrjen, se si do të ulet numri i punëtorëve në administratë, të rritet numri i punëtorëve në terren, se pastrimi nuk bëhet prej zyrave, pastrimi bëhet prej punëtorëve të terrenit dhe aty do të kemi rritje të numrit të punëtorëve të cilësisë, të makinerisë e kështu me radhë. Ndërmarrja komunale "Pastrimi" meriton përkrahje, jo menaxhmenti, kështu që ndihma jonë, përkrahja jonë do të jetë e kushtëzuar në terma të afateve dhe të rezultateve që priten dhe të veprimeve që patjetër duhet ndërmarrur prej menaxhmentit.

Arianit Beqiri tha se, ne e dimë se pastrimi i qytetit nuk ka qenë shumë i mirë viteve të kaluara edhe nëse ndodh pastrimi i qytetit, kushtet jo të mira që i kanë punëtorët në kompaninë "Pastrimi" bënë që lagjet dhe hapësirat tjera edhe të kundërmojnë, por sigurisht kjo nuk është për shkak të dëshirës së punëtorëve të pastrimit, sepse me kushtet që i kanë ata e bëjnë maksimumin e mundshëm, mirëpo krahas kësaj duhet të mendojmë edhe për kushtet dhe formën se si punojnë ata. Ne prapë do të ulemi në një rast tjetër e do të flasim se si mundemi me i avancuar kushtet brenda "Pastrimit", dhe si mundemi që "Pastrimi" me qenë prapë ndërmarrje shembull, qysh e kemi bërë edhe më herët Ndërmarrjen Publike Banesore.

Gëzim Mehmeti u shpreh se unë i kam dorëzuar disa propozime, të cilat disa janë marrë parasysh e disa jo, kështu që ka propozime, plotësime, po ashtu ka edhe nene të reja. Kam propozuar që neni 1 i kësaj rregulloreje të plotësohet edhe më tej. Po ashtu duhet të plotësohet edhe neni 2, të përcaktohet qartë që regjistri i amvisërisë të përfshijë të dhëna për konsumatorë komercial dhe institucional. Neni 4 duhet t'i shtohet "Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme dhe mjekësore". Te neni 5 duhet të bëhet plotësim-ndryshimi i tij.

Gjithashtu, duhet të bëhen ndryshime edhe në nenin 18, si dhe duhet të jetë edhe një nen, i cili do ta parasheh një sistem monitorimi për të evidentuar përqindjen e mbeturinave të riciklimit në nivel komunal.

Nora Kelmendi tha se ne, grup i Lëvizjes Vetëvendosje, mendojmë që duhet të bëhen disa ndryshime në këtë rregullore. Ndryshimin në paragrafin 1 të nenit 12, të ndryshojë periudha prej 5-vjeçare në 3-vjeçare. Paragrafi 2 i nenit 14 ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim: "Faturimin i taksave të mbeturinave bëhet në baza mujore, kurse fatura i dorëzohet gjeneruesit të mbeturinave përmes inkasantëve të KRM "Pastrimi"". Paragrafi 2 i nenit 16, të shtohet një paragraf i ri: "Kompania e kontraktuar publike "Pastrimi" sipas nenit 16, paragrafi 2 i kësaj rregulloreje, është i obliguar të regjistrojë dhe të mbajë regjistër të klientëve të amvisërisë dhe bizneseve, dhe njofton Komunën sipas kërkesës së saj lidhur me përditësimin e regjistrit të klientëve. Po ashtu, paragrafi 2 i nenit 14, shtohet paragrafi i ri 2a dhe 2b: "Kompania "Pastrimi" faturon bizneset e vogla, të mesme dhe të mëdha, si dhe institucione në Komunën e Prishtinës, për të cilën ka kontrata të veçanta. Pastaj paragrafi 2 i nenit 16, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: "Operatori publik i kontraktuar".

Triera Kasumi - Berisha tha se ekzekutivi i Komunës në vend që të reflektojnë, kanë zgjedhur të rrisin dosjen e keqpërdorimeve, duke kaluar në tender të dyshimtë në shifra marramendëse, që nuk i kontribuojnë askujt tjetër, aq më pak qytetarit, përveç të xhepave të individëve. Tenderi prej 16.5 milionë euro, e që e quajmë investim, është shembulli më i mirë i një fundi të këtij mandati, i cili është totalishtë i papërgjegjshëm. Po ashtu, ky nuk është investim për qytetarët, është abuzim i fondeve publike dhe është pasurim i individëve të cilët veçse e kanë humbur totalisht interesin për publikun.

Ermal Osmani u shpreh në mbështetje të këtij plotësim-ndryshimi të rregullores dhe falënderoi punëtorët e terrenit për punën që e bëjnë.

Nora Kelmendi i paraqiti 3 propozime dhe 3 kushte për bordin, menaxhmentin, si dhe Komunën, të cilat duhet të plotësohen patjetër deri në mars, 2025:

1. Që nga nesër të ndërpriten të gjitha punësimet në SHA "Pastrimi";
2. Në fillim të muajit mars të na sillet raporti në Kuvend mbi performancën e kompanisë dhe në qoftëse nuk ka përmirësime, të merren masa ndaj bordit dhe menaxhmentit të SHA "Pastrimi";
3. Komuna t'i ndërmarrë të gjitha masat për plotësimin e granteve nga Qeveria gjermane dhe KFW.

Leutrim Retkoceri theksoi se duke marrë parasyshë se gjatë kësaj seance kemi edhe amandamentime si kërkesa të reja për plotësim dhe ndrysim të rregullores, nga drafti që është dërguar me email, atëherë po i bëjmë edhe disa plotësime, në mënyrë që të votohen propozimet si të tëra. Pajtohem me propozimin e z. Mehmeti, që neni 1. "Qëllimi" i kësaj rregulloreje të plotësohet. Në nenin 2, pas paragrafit 2 të nenit 16, shtohet paragrafi i ri "Treg", me tekst si në vijim: "Kompania e ka të obliguar të regjistrojë dhe të mbajë regjistër të klientëve të amvisërisë dhe të bizneseve, dhe ta njofton Komunën, sipas kërkesës së saj,

lidhur me përditësimin e regjistrave të klientëve". Neni 3, paragrafi 1 i nenit 12, ndryshohet dhe plotësohet, neni 3 pas paragrafit 2 të nenit 14 të rregullores bazë, shtohet paragrafi i ri 2a dhe 2b, si dhe shtohet 2c . Gjithashtu, neni 5, pika 3 për paragrafin 2 të nenit 16, shtohet paragrafi i ri 2a. Në nenin 3, paragrafin 7 të kësaj rregulloreje, pra pika 4 paragrafi, 3 i nenit 16 largohet. Pas paragrafit 5 të nenit 18, shtohen paragrafët e ri 6 dhe 7. Kërkoj që këto propozime të hedhen në votim.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e znj. Kelmendi.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, u miratuan propozimet e znj. Kelmendi.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e z. Retkoceri.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, u miratuan propozimet e z. Retkoceri.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për dhe 1 abstenim, u miratua ndryshim- plotësimi i Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, nr. 01-030/01-227581/23, dt. 1.12.2023.

Mbledhja përfundoi në orën 17:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi



Faqe 6 nga 6